



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot. 03-03-679/18  
 Prot No.  
 Data Datum 14.03.2018  
 Date  
 PRISHTINË

DATË/A:	13.03.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-679/18
PËR/ZA/TO:	z. Mehmet RAMA Menaxher i zyrë së Prokurimit Komuna e Gllogocit
CC:	z. Ramiz LLADROVCI Kryetar i Komunës Gllogocit
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: <b>“Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Sankoc, Kizharekë dhe Komoran (Lagjia e Re)”</b> me nr. të prokurimit 611/18/1220/521, nr. të brendshëm 611/18/018/521.

*E nderuari z. Rama,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Sankoc, Kizharekë dhe Komoran (Lagjia e Re)”** me nr. të prokurimit 611/18/1220/521, nr. të brendshëm 611/18/018/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Sankoc, Kizharekë dhe Komoran (Lagjia e Re)”** me nr. të prokurimit 611/18/1220/521, nr. të brendshëm 611/18/018/521, në mënyrë që të respektohen

dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

### *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 07 mars 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-679/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Sankoc, Kizharekë dhe Komoran (Lagjia e Re)”** me nr. të prokurimit 611/18/1220/521, nr. të brendshëm 611/18/018/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Glllogocit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike kornizë të llojit shërbime, me vlerë të madhe. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur që njoftimin për kontratë në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: *“Të paraqitën proceset-pranimet e punëve të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit (nga data e Njoftimit për kontratë min. 80,000.00€)”*, ndërsa tek dëshmia e kërkuara dokumentare është kërkuar: *“Lisat e referencave të natyrës së ngjashme, të bashkangjitura me kopjet e pranimeve, proceseve apo referencave ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qartë shumën, numri i prokurimit, viti, titulli etj, ose proceset e pranimeve nga personat privat me kusht që pagesat të jenë kryer nëpërmes institucioneve bankare”*, kërkesë kjo për të cilën Agjencia gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26.8 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket referenca, kopje të pranimeve teknike ose procese të pranimeve të autoriteteve publike dhe personave privat, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues duke cekur vetëm kopjet e pranimeve, proceseve apo referencave nga personat privat me kusht që pagesat të jenë kryer nëpërmes institucioneve bankare .

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e tenderit si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Agjencia pas trajtimit të dokumentacionit për tenderin me titull: *“Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës” me nr. të prokurimit 60100/18/1045/211, nr. të brendshëm 60100/18/003/221*, ju njofton me të gjeturat e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*

